



Prishtinë: 27.05.2009

Kodi i ZRRE-së: V\_183\_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_209\_05\_09

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_V\_209\_05\_09;
5. Apeli i konsumatorit i datës 25.05.2009; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2009 nxori këtë:**

### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Fazli Dervisholli (shifra e konsumatorit DPR – 90033040) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 07.05.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 22.04.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 13.02.2004 KEK-u ka bërë regjistrimin e njehsorit elektrik nr. 17736093 me anë të procesit të pranimit të instalimit.  
**Provë:** Procesi i pranimit të instalimit i KEK-ut të datës 13.02.2004
- Me datë 18.01.2008 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut kanë dalur tek konsumatori dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 17736093 vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull si dhe vulozet me vulë distributive të KEK-ut.  
**Provë:** Procesverbali nr. 0104597 të datës 18.01.2008
- Me datë 04.04.2008 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut kanë dalur tek konsumatori dhe kanë konstatuar se dyshohet në xhamin e njehsorit nr. 17736093 dhe se duhet të dërgohet në kalibrim.  
**Provë:** Procesverbali nr. 0119350 të datës 04.04.2008

- Me datë 23.05.2008 zyrtarët e autorizuar e KEK-ut kanë hequr njehsorin nr. 17736093 dhe kanë vendosur njehsorin ri nr. 2999801.  
**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit i KEK-ut nr. 004758 të datës 23.05.2008
- Me datë 09.09.2008 Qendra e Kalibrimit gjatë kontrollimit detal të njehsorit nr. 17736093 ka konstatuar se përreth qelqit nga ane djathtë është futur shiriti filmik dhe se ka pluhur të shiritit filmik.  
**Provë:** Procesverbali i Qendrës së Kalibrimit nr. 21/9 të datës 09.09.2008
- Me datë 19.12.2008 zyrtarët e autorizuar të shërbimit të kontrollës të KEK-ut kanë dalur tek konsumatori dhe kanë regjistruar të dhënat teknike të pikës matëse.  
**Provë:** Procesverbali nr. 208694 të datës 19.12.2008
- Me datë 16.03.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar sipas faturës DPR09HP07396 në shumë prej 1,020.34 €  
**Provë:** Fatura DPR09HP07396 të datës 16.03.2009
- Me datë 31.03.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 22.04.2009 Departamenti për konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në proceset e kontrollës dhe procesin e kalibrimit.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 22.04.2009
- Me datë 07.05.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e KEK-ut në DMK të ZRRE-së
- Me datë 13.05.2009 DMK në ZRRE ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka pranuar pjesërisht ankesën e konsumatorit lidhur me kontestimin e ngarkesës për shfrytëzim të paautorizuar.  
**Provë:** Përgjigja e DMK së ZRRE-së e datës 13.05.2009
- Me datë 25.05.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_209\_05\_09.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK\_V\_209\_05\_09** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar